

NEWSLETTER

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Gjatë muajit mars, Bordi i ERE-s ka zhvilluar 3 mbledhje, që kanë rezultuar në 11 vendimmarrje, ndër të cilat:

1. Licencimin e shoqërisë "DELIU 3D" sh.p.k në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC "Shiroku", me kapacitet të instaluar 1,6 MW, me vendndodhje në pellgun ujëmbledhës të përroit të Holtës dhe përroit të Hotomizës me derdhje në përroin e Holtës, degë e Lumit Devoll, Bashkia Gramsh, Qarku Elbasan, për një afat 30-vjeçar. Në referencë të përcaktimeve të nenit 9 të Kontratës së nënshkruar me MIE-n, të dokumentacionit të depozituar në ERE në kuadër të këtij aplikimi, si dhe parashikimit të bërë nga shoqëria, ky hidrocentral pritet të futet në operim brenda datës 30.06.2025.

2. Fillimin e procedurës për licencimin e shoqërive "RENEW" shpk, "GREEN ENERGY" shpk dhe "Solar Horizon" shpk në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centralet fotovoltaike me kapacitet prodhues 2MW secila, dhe vendndodhje në Qarkun Fier.

3. Mbi kërkesa të ndryshme nga të licencuar:

a. Pranimin e kërkesës së shoqërisë "GREEN ENERGY TRADING ALBANIA" shpk për heqjen e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 59, datë 23.04.2015 dhe rinovuar me vendimin nr. 72, datë 22.04.2020.

b. Pranimin e kërkesës së shoqërisë "GREEN ENERGY BILISHTI" shpk dhe dhënien e autorizimit të ERE-s për vendosjen e kuotave të shoqërisë si mjet (barrë siguruese) për garantimin e përmbushjes së detyrimeve ndaj të tretëve.

c. Dhënien e autorizimit të ERE-s për vendosjen e kuotave të shoqërisë "DRINI BULQIZE" sh.p.k si mjet për të garantuar përmbushjen e detyrimit, ndaj palës kredidhënëse, "Banka OTP Albania" sh.a.

Për tu njohur me këto vendime dhe të tjera, në mënyrë më të detajuar, ju ftojmë të vizitoni faqen tonë zyrtare www.ere.gov.al në kategorinë [vendime](#).

Në këtë gazetë do të lexoni mbi

Licencime të muajit në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike

Fillime të procedurave për licencim

Raporti Vjetor

Tarifa dhe çmime

Seanca dëgjimore

Platforma PCT

Aktivitete

NEWSLETTER

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Zgjatjen me deri në 30 (tridhjetë) ditë të afatit të vendimmarrjes së Bordit të ERE-s për shqyrtimin e kërkesave të shoqërive:

- “GRABOVA HYDROPOËER” shpk për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, pasi shoqëria është në pritje të zbardhjes së lejes së ndërtimit, dokumentacion i nevojshëm për të gjykuar me aspekte të tjera të aplikimit për licencim;
- “GEGA-G” shpk për rinovimin e licencës së shoqërisë në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 64, datë 08.04.2020 pasi nuk ka plotësuar të gjitha dokumentacionet e nevojshme sa përcaktuar në rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike.

Mbi miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit (FMF), për muajin shkurt 2025 prej 19.76 Lekë/kWh për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.

Për tu njohur me këto vendime dhe të tjera, në mënyrë më të detajuar, ju ftojmë të vizitoni faqen tonë zyrtare www.ere.gov.al në kategorinë [vendime](#).

Seanca dëgjimore

Gjatë muajit mars, ERE ka zhvilluar 8 seanca dëgjimore me konsumatorë dhe subjekte të licencuara, duke adresuar çështje të ndryshme që lidhen me ushtrimin e përgjegjësive nga ERE. Këto takime u fokusuan në:

1. Zgjidhje të mosmarrëveshjeve mes tre konsumatorëve fundore dhe të licencuarve FSHU sha dhe OSSH sha.
2. Sqarimin e detajeve mbi aplikime të ardhura në ERE të katër subjekteve në fazë licencimi për herë të parë, rinovimi të licencës apo dhe kërkesa të ndryshme.
3. Trajtimin e mosmarrëveshjes mes një subjekti të licencuar në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike dhe OSSH sha, të lindur për shkak të rifuqizimit të një nënstacioni elektrik dhe pasojat që kanë ardhur pas këtij modifikimi.

Këto seanca janë një tjetër mekanizëm i ERE në objektivin e saj për transparencë dhe rritje të efikasitetit të shërbimeve nga ERE, duke përfshirë të gjitha palët e interesuara.

NEWSLETTER

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Publikime

Duke shfletuar faqen tonë zyrtare www.ere.gov.al, mund të njiheni me regjistrat e licencimit të subjekteve, të garancive të origjinës dhe të ankesave të përditësuar, si dhe tarifat dhe çmimet të miratuara nga ERE. Po ashtu në zbatim të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e energjisë elektrike”, neni 19, gërma k), gjenden të publikuara në faqen e internetit të dhëna për vitin 2024 për funksionimin e tregut të energjisë elektrike, në linkun e mëposhtëm: (https://ere.gov.al/media/files/2025/02/17/media/files/2025/01/08/PUBLIKIMI_12-_Mujor_2024.pdf)

Aktivitete

Presidenti i Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, z.Artur Lorkowski, zhvilloi një vizitë dyditore në Shqipëri (17-18 mars) për të diskutuar përshejtimin e integritit të tregut të energjisë elektrike.

Gjatë vizitës së tij, ai paraqiti gjetjet e Raportit të Zbatimit 2024 në Komisionin për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin në Kuvendin e Shqipërisë, duke theksuar urgjencën e transpozimit të kuadrove ligjore kritike, si Paketa e Integritit të Tregut të Energjisë Elektrike, për të forcuar lidhjen e Shqipërisë me tregun energjetik të BE-së përpara anëtarësimit të plotë të vendit në BE, si dhe mbi nevojat për investime dhe hapat e ardhshëm në tranzicionin energjetik të Shqipërisë.

Z. Lorkowski u takua gjithashtu me disa figura të njohura të sektorit energjistik në Shqipëri, ndër të tjerë dhe me Kryetarin e ERE-s z. Petrit Ahmeti sëbashku me anëtarë të Bordit në ambjentet e Entit Rregullator të Energjisë, ku diskutimet u përqendruan në hapat politikë të nevojshëm për të përshejtuar reformat e tregut të energjisë.



NEWSLETTER

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Raporti vjetor 2024

Enti Rregullator i Energjisë ka dorëzuar në përfundim të muajit mars, Raportin Vjetor për vitin 2024 në Kuvendin e Shqipërisë. Ky raport i përvitshëm paraqet në mënyrë të detajuar të dhëna mbi ecurinë e Sektorit të Energjisë Elektrike dhe të Gazit Natyror për vitin 2024, si dhe krahasimet e disa prej treguesve kryesorë të këtij viti me vitet paraardhës. Në raport gjithashtu do të gjeni informacion mbi aktivitetin e ERE-s në të gjitha fushat e veprimtarisë së saj, gjatë vitit që lamë pas, si dhe objektivat kryesorë për vitin 2025. Për ta shfletuar më tej ju ftojmë të vizitoni linkun e mëposhtëm:

https://ere.gov.al/media/files/2025/04/03/media/files/2025/03/05/Raporti_Vjetor_2024.pdf

Njoftim për Klientët në treg të lirë

Mbi furnizimin nëpërmjet “Furnizuesit të Mundësisë së Fundit” dhe përdorimin e Platformës së krahasimit të çmimeve PCT



Gjithashtu risjellim në vëmendje që, të gjithë konsumatorët që kanë plotësuar kriteret për daljen në treg të lirë dhe që nuk kanë mundur të kontraktojnë vetë një furnizues ose kanë humbur furnizuesin e tyre, mund të përfitojnë nga furnizimi nëpërmjet “Furnizuesit të Mundësisë së Fundit” i cili është një furnizues i caktuar në përputhje me dispozitat e ligji të sektorit të energjisë elektrike, dhe që ofron për një periudhë të kufizuar kohe (60 ditë) shërbimin e furnizimit në kushte të rregulluara. E drejta për të zgjedhur dhe për të ndryshuar pa pagesë furnizuesin është e garantuar me ligj. Ju ftojmë të shfletoni platformën e krahasimit të çmimeve PCT (Price Comparison Tool), të ndërtuar nga ERE [Mbi furnizimin nëpërmjet “Furnizuesit të Mundësisë së Fundit” dhe përdorimin e Platformës së krahasimit të çmimeve PCT](#), ku mund të kërkonti dhe gjeni ofertat me të mira të furnizimit për kategorinë së cilës i përkisni.